



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**URDHËR**

Nr. 165, Datë 13.09. 2011

**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E SHITESËS SË PAGËS PËR  
VËSHTIRËSI PUNE PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “gj” i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) dhe neneve 12/a pika 5 të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (i ndryshuar);

**URDHËROJ:**

1. Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për dhënien e shtesës së pagës për vështirësi pune për oficerët e Policisë Gjyqësore duhet të jetë i arsyetuar dhe të përfshijë krahasimin me kushtet normale të punës.

2. Konsiderohen kritere për të cilat jepet shtesa e pagës për vështirësi pune rastet kur:

a) oficeri është caktuar ose transferuar përkohësisht në një seksion me kushte të vështira për shkak të logjistikës ose rrezikut që lidhet me veprimtarinë. Në rast se oficeri transferohet përkohësisht, shtesa e pagës do të kufizohet vetëm për periudhën në fjalë;

b) veprimtaria kërkon kompetenca të specializuara dhe të jashtëzakonshme, si njohuri dhe zotërim të teknologjive speciale ose disiplinave teknike;

c) volumi i punës është jashtëzakonisht më i madh se mesatarja dhe çështjet e trajtuara janë veçanërisht komplekse, për shkak të numrit dhe rëndësisë së krimeve, numrit të të pandehurve, implikimeve ndërkombëtare dhe volumit të provave.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtuesit e të gjitha hallkave të Prokurorisë, Drejtoria Ekonomike dhe e Financës dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**



**INA RAMA**